

## NDIHMESA E REVISTËS 'PËRPJEKJA SHQIPTARE' PËR GJUHËN SHQIPE

Shkëlqim MILLAKU, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti 'Ukshin Hoti' Prizren  
shkelqim.millaku@uni-prizren.com

### Abstrakt

Numri i parë i revistës mujore 'Përpekja shqiptare' doli në tetor 1936 dhe vazhdoi deri në dhjetor 1938. Në këtë revistë janë shtruar tema të ndryshme nga gjuhësia, letërsia, sociologjia, psikologjia, pedagogjia, historia, ekonomia, sporti e tema të tjera. Siç dihet, gjuha e revistës nuk është standarde dhe si e tillë ndihen mungesë kriteresh. Studiuesit që kanë botuar në revistë në fjalë janë të shumët dhe kanë bërë përpekje serioze për t'i trajtuar tema të ndryshme, me tematika të ndryshme, të cilat, e kanë brumëzuar revistën, por edhe i kanë parapri proceseve të ndryshme gjuhësore, qoftë për trajtime të ndryshme për standardizimin e gjuhës, apo trajtime për ruajtjen dhe kultivimin e saj. Studiuesit të ndryshëm që kanë publikuar në revistë janë: Xhuvani, Riza e shumë dashamirës të tjerë të gjuhës, të cilët përmes punimeve të tyre e kanë ngritur vlerën kulturore, publicitare e shkencore të revistës. Përmes punimeve të ndryshme, të fushave të ndryshme, revista ka dhënë një ndihmesë të arsyeshme për ta ruajtur e kultivuar gjuhën, por edhe ka luajtur një rol tepër të rëndësishëm për ta informuar shoqërinë.

*Fjalë çelës: Revista, gjuha shqipe, studiuesit, publikimet.*

### The Contribution of the Magazine 'Përpekja Shqiptare' to the Albanian Language

#### Abstract

The first issue of the monthly journal *Përpekja shqiptare* was published in October 1936 and continued until December 1938. The journal addressed a wide range of topics including linguistics, literature, sociology, psychology, pedagogy, history, economics, sports, and more. As is well known, the language of the journal was not standardized, and thus the lack of linguistic consistency and criteria is noticeable. Numerous scholars contributed to the journal, undertaking serious efforts to address diverse issues. Their contributions not only enriched the journal's content but also anticipated key developments in Albanian linguistics - particularly in relation to the standardization, preservation, and cultivation of the language. Among the authors featured in the journal were Aleksandër Xhuvani, Selman Riza, and many other advocates of the Albanian language, whose work elevated the cultural, journalistic, and scholarly value of the publication. Through the variety of academic and thematic fields it encompassed, *Përpekja shqiptare* made a valuable contribution to language preservation and development, while also playing a significant role in informing and shaping public discourse in Albanian society.

*Keywords: journal, Albanian language, scholars, publications*

## Hyrje

Revista 'Përpyekja shqiptare' trajton tema të ndryshme, të fushave të ndryshme, si nga gjuhësia, letërsia, filozofia, sociologjia, ekonomia e fusha të tjera, mirëpo studimi ynë është i fokusuar vetëm në shkrimet që trajtojnë çështje të ndryshme gjuhësore. Gjuha e revistës nuk është e shqipes standarde, mirëpo si revistë e tillë kulturore ka trajtuar tematika interesante për të ruajtur, zhvilluar, kultivuar dhe janë bërë përpjekje serioze për ta unifikuar gjuhën. Pesha e punimeve ngritët në rastet kur autorët i analizojnë punimet e studiuesve dhe pastaj në numrat e radhës i paraqesin kritikën e tyre gjuhësore, të cilët, përmes argumenteve gjuhësore, i shpalosin mendimet e tyre, për një shqipe normative dhe gjithëpërfshirëse.

Autorë që kanë kontribuar përmes publikimeve të ndryshme kanë dëshmuar se kishin kulturë gjuhësore të shtrirjes kombëtare e ndërkombëtare, kështu që duke i menduar se në çfarë rrethanash kanë krijuar, konsideroj se ishin dhe janë pishtarët e parë serioz që kanë bërë hapat e parë për kodifikimin e sistemimin gjuhësor të shqipes. Liria e shprehjes nuk ka qenë në nivelin e lirë e demokratik. Mendimtarët e fushave socio-arsimore, gjithashtu edhe ato socio-edukative e ekonomiko-juridike nuk kanë pasur lirë të plotë akademike për ta shprehur fjalën e lirë profesionale. Për ta argumentuar këtë mendim, e citoj aktin e ndalimit të revistës: 'Kemi nderin me ju njoftue se Këshilli Ministrues, me vendimin e tij Nr. 711 datë 30-6-1938, ka vendosur ndalimin e botimit për katër muaj të Revistës 'Përpyekja Shqiptare' qi drejtoni z. E juaj, për arsye se, në kundërshtim me deklaratimet në kërkesë dhe të përmbajtjes së lejes, në një artikull të numrit të fundit, ka përdorë fjalë diskredituese dhe asht përzie në çashtje fetare, tue shkel kështu qëllimin qi ndiqet me revistat kulturore'.

Kjo situatë nuk ndalet edhe me kaq, mirëpo vazhdohet edhe më kërkesa të tjera, si: Petro Marko shkruan sesi bashkëpunuan edhe në revistën "Përpyekja shqiptare", e cila drejtohej nga Branko Merxhani. Ndër të tjera, ai thekson sesi u thirrën nga Ministri i Brendshëm, pra nga Musa Juka, i cili u kishte thënë: "Kam urdhër nga Naltmadhnia t'ju komunikoj se, nëse dëshironi vazhdimin e botimit të revistës "Përpyekja Shqiptare", duhet të bëni një deklaratë në faqen e parë se nuk jeni komunistë (Pertefe, 2021).

Mbështetur në këtë gjendje faktike mund të themi se nuk ka qenë e lehtë për të shkruar e publikuar, në atë kohë kur studiuesit kanë bërë përpjekje për të kontribuar e unifikuar gjuhën. Në këtë revistë janë publikuar shkrime të ndryshme, mirëpo fokusi unë është për shkrimet që i dedikohen gjuhës dhe si të tilla janë mbi rreth njëzet shkrime, pra për gjuhën, kurse disa nga ato shkrime dhe autorët që i kanë publikuar janë:



# PËRPPJEKJA SHQIPTARE

REVISTË KULTURALE E PËRMUAJSHME

Viti II.

Tiranë, Dhjetor 1938

Nr. 18-24

## AKTI I NDALIMIT



MBRETËRIJA SHQIPTARE

Ministria e Punëve të Jashtme

DREJTORIJA E SHTYPIT

Prot. Nr. 697

Tiranë, me 6/VII/1938

Z. Branko Merxhani  
Drejtor i Revistës  
«Përppjekja Shqiptare»

K ë t u

Zoti Drejtor,

Kemi nderin me ju njoftue se Këshilli Minis-  
truer, me vendimin e tij Nr. 711 datë 30-6-1938, ka  
vendosur ndalimin e botimit për katër muaj të Re-  
vistës «Përppjekja Shqiptare» që drejtoni z. e juej, për  
arsye se, në kundërshtim me deklaratimet në kërkesë  
dhe të përmbajtjes së lejës, në një artikull të num-  
rit të fundit, ka përdorë fjalë diskredituese dhe  
asht përzile në çashtje fetare, tue shkel kështu që-  
llimin që ndiqet me revistat kulturore.

Me nderime

P. Drejtor i Shtypit  
Halil MAÇI (d.v.)

shqiptare', nr. 17, 1938, f. 243.

Selam Riza ka botuar: 'Shqiponja dhe Shqipja', Përppjekja shqiptare, nr.1, 1936, f.28; Dilettantismi dhe zanati, Përppjekja shqiptare, Tiranë, nr.14-15, 1938, f. 82-83. Shpend Bardhi ka botuar: Kritikë një kritike, 'Përppjekja shqiptare', nr. 17, 1938, f. 271; Origjina e popullit shqiptar, 'Përppjekja shqiptare', nr. 18-24, 1938, f. 332; Rreth fjalëve të Lagushit, 'Përppjekja shqiptare', nr. 18-24, 1938, f. 405 etj. Studiuesit në fjalë kanë trajtuar, analizuar e kritikuar për çështje të ndryshme gjuhësore. Në këtë studim kemi analizuar mbi njëzet shkrime të ndryshme, të cilat janë të publikuara e botuara në revistën 'Përppjekja shqiptare', e cila revistë, përmes këtyre shkrimeve publicitare e shkencore dha një ndihmesë të çmuar për gjuhën dhe kulturën tonë.

### Përshkrimi i punimeve

Numri i parë i revistës 'Përppjekja shqiptare' është publikuar në tetor të vitit 1936, kështu që kemi disa dashamirësi të gjuhës, të cilët i kanë publikuar shkrimet e tyre, por edhe i kanë trajtuar disa çështjet gjuhësore, të cilat ishin me interes për gjuhën. Autorët që kanë kontribuar në këtë numër janë: Aleksandër Xhuvani ka kontribuar më shkrimin 'Dy antologjijat shqipe; pastaj Selam Riza me shkrimin 'Shqiponja dhe shqipja', por në këtë numër janë publikuar edhe poezi të ndryshme, si poezia e Lasgushit, me titull: 'Më zu një mall'; pastaj ajo e Ernest Koliqit që është shkruar në dialektin e Shkodrës, kurse ajo e Andrea Varfi në atë të toskërisht, por edhe poezia e Hispani që është shkruar në dialektin e mesëm, të gjitha këto kanë pasqyruar një përppjekje serioze për t'i përfshirë disa qendra kulturore.

Aleksandër Xhuvani ka botuar disa shkrime, si: 'Dy antologjijat shqipe', 'Përppjekja shqiptare', nr.1, 1936, f.22; 'Kritika, e kritikës mbi kritikën', 'Përppjekja shqiptare', nr.1, 1936, f. 90; Fjalori i Angelo Leottit, 'Përppjekja shqiptare', nr. 4,5,6, 1937, f. 209; Gjashtë dhjetëvjetori i Prof. Joklit, 'Përppjekja shqiptare', nr. 4,5,6, 1937, f. 209; Nji didaktik' e re n'italisht, 'Përppjekja shqiptare', nr. 8, 1937, f. 81. (Libri është i autorit Guiseppe Lombardo-Radice, Lezioni di Didattica', Palermo, 1936); Përgjigje z. Filip Fishtës, 'Përppjekja shqiptare', nr. 7, 1937, f. 31 etj.

Dimitër Shuteriqi ka botuar dy shkrime: Arti i Migjenit, 'Përppjekja shqiptare', nr. 18-24, 1938, f. 399; Për një Drejtim Letrar, 'Përppjekja shqiptare', nr. 8, 1937, f. 101. Eqrem Çabej ka botuar: Një libër mbi Literaturën Shqipe, Përppjekja shqiptare, nr.2, 1936, f. 124. Et'hëm Haxhiademi ka botuar: Një Polimikë Letrare, 'Përppjekja shqiptare', nr. 8, 1937, f. 124. Filip Fishat ka botuar: Dy fjalë me Aleksandër Xhuvanin, Përppjekja shqiptare, nr. 3, 1936, f. 153. I. Arbëreshi ka botuar: Disa vërejtje gjuhësore, Përppjekja shqiptare, nr.3, 1936, f. 148. Krsit Maloki ka botuar: A asht poet Lasgush Poradeci, 'Përppjekja shqiptare', nr. 18-24, 1938, f. 333; Poetika e Lasgush Poradecit, 'Përppjekja

Shkrimi i parë i Aleksandër Xhuvani është: 'Dy antologjijat shqipe', i cili i trajton 'dy antologji' për shkollat e mesme, atë të Fishtës dhe të grupit autorëve, të N. Palucës, K. Kamçit dhe E. Koliqit. Në këtë shkrim përshkruhen, trajtohen e propozohen disa çështje fonetike, leksikore e morfologjike, kështu që shkrimi i trajton bashkëtingëlloret g – gj, pastaj i përshkruan disa folje që dalim me temë me zanore /-oj/, e /-ej/, mirëpo koncepti i tij ideor ishte edhe më i thelluar, sepse edhe e ka thënë: 'Autori i një libri, e ma fort ai i një libri të gjuhës, duhet me ja caktue vedit një mënyrë shkrimi t' orthografisë, të cilën lypset me e rrujtë në krejt veprën e tij. Ai duhet me qenë konsekuent në mënyrën e të shkruemit, me zgjedhë një rrugë mbas mendjes së vet kësaj me i ndetë gjithmonë pa e ndrrue dorën. P.sh. të shkruajmë: me punue, ose me punuem, tue punue ose tue punuem; shkojshe a shkoshe a shkojshem, shkonja a shkoja; punojmë a punojm, emëri a emri; zemëra a zemra; e bukurë a e bukur; i sotshëm a i sotshmë; e sotshëme a e sotshme ... etj (Xhuvani, 1936)'.

Xhuvani e konsideron punë shumë të vështirë për të hartuar libra të këndimit të tillë, kurse autorët e antologjive në fjalë i vlerëson, sepse kanë bërë një punë të vyer dhe me interes për shoqërinë. Shkrimi i radhës është 'Shqiponja dhe Shqipja' e botuar nga S. Riza, i cili ka thënë: 'Për të mënjanuar dualizën t' onë dhjalektike, kemi vetëm tri mënyrë:

– Të ngrehim njërin dhjalekt në lartësin e një gjuhe shkrimi të përbashkët dhe të lëmë tjetrin jashtë përdorimit zyrtar, shkollor dhe letrar, kështu që të prapset dita ditës, të zhduket dalngadal, në saje të përhapjes s'arsimit botor dhe të letërsis kombëtare.

Të gatuajmë bashk një ideomë eklektike nga brumi i dy kryedhjalektevet.

Të privilegjojmë një nëndhjalekt, për hir të një situate gjeografike të mesme, së cilës besojmë që ay t'i detyrojë një analogji bipolare me dy kryedhjalektet fëqinj (Riza, 1936).

Riza vazhdon duke e kuptimësuar mendimin, i cili thotë:

'Për hatër të një begatije idiomatike të barabartë me folklorin e gegërishtes, për hatër të një orthografije më të plotë dhe të një fonetike më muzikale, për hatër të një syntakse më t' evoluar drejt shprehjes analytike, dhe sado anëtar të jem – për arsyet e çfaqura më sipër të një fizionomije të njëlljoshme dhe të një homogjeneiteti në cipët – nuk mund veçse të përgëzohem botërisht që në saje të prestigjit të kryeshkrimtarëve dhe të mbrothësis së publikut tosk, toskërishtja të mos jetë destinuar të bjerë në radhën e një së foluri vetëm dhe thjesht popullor. Shkabën e flamurit e kemi me dy krerë. Gjuhën e kombit do t'a kemi me dy kryedialekte (Riza, 1936)'.

Kontributi i Xhuvanit dhe i Rizës mund të konsiderohet i rëndësishëm dhe themeltar. Numri i parë i revistës, siç shihet në analizën e shkrimit të parë dhe të dytë ka trajtime e publikime nga autorët të ndryshëm, të cilët përmes punës së tyre kanë zënë vend meritore dhe mund të quhen titullar e serioz, sepse ata ishin ideator për standardizimin e gjuhës.

### **Numri i dytë i revistës doli në nëntor të vitit 1936.**

Në këtë numër, Aleksandër Xhuvani ka botuar shkrimin: 'Kritika, e kritikës mbi kritikën', pastaj kemi edhe disa poezi dhe shkrime të tjera me përmbajtje kombëtare e ndërkombëtare, të cilat e kanë kompletuar numrin e revistës. Publikimi i studimit të Xhuvanit: 'Kritika, e kritikës mbi kritikën' është një risi e komunikimit me publikun, sepse deri me tani nuk kishte edhe aq kritika të tilla, të cilat trajtonin çështjet e kritika të ndryshme gjuhësore, prandaj edhe e citoj një fragment: Kritika e Shpend Bardhit mbi libërthin t'em, 'Kritikë mbi Fjalorë të Shqipes' edhe mbi Fjalorin e Cordignano-s u botue së parit në 'Lekët' e mbasandaj në 8 numra të 'Hylli i Dritës' në No.2,3,5,6,9, 10, 11 e 12 të vjetit 1935prej faqes 102 deri 599. Kësaj kritike të hollë e të fellë që e vë auktorin në radhën e parë leksikografësh të shquem të Shqipes, unë s'kam gja të madhe t'i shtoj a t'i kundërshtoj, prandaj veç këtyneve ma poshtë

s'gjeta gja tjetër ç't'i themi. Tue i përgjegjës po shënoj vetëm faqet e 'Hyllit të Dritës' ku qenket fjala e fraza për të cilën po hahem, mbaron citimi (Xhuvani, 1936). Në vazhdim të kësaj kritike gjuhësore janë trajtuar edhe disa fjalë, si: baltikë, beft, buzangas, ceni, haliqe, hamitun, hetim, kërkësuri, luar, mbres, zi, mrekuull, shprehun, shtjekëzat (Çabej, 1936) etj.

Në këtë shkrim është treguar një ngritje e lartë shkencore, sepse çështjet gjuhësore janë trajtuar jo vetëm për dallueshmërinë e dy dialekteve të shqipes, por edhe për etimologjinë e fjalës dhe krahasueshmëri e saj me gjuhët e tjera.

Një shkrim tjetër më interes është ai nga Eqrem Çabej, i cili ka botuar: 'Elemente të Gjuhësisë e të Literaturës Shqipe (Çabej, 1936)'. Në këtë shkrim trajtohen çështje thelbësore e kritike për gjuhën, mirëpo mund të konsiderohet edhe pasurim për revistën, sepse këtu na krijohet edhe një kritikë profesionale.

### Numri i tretë

Numri i tretë është botuar në dhjetor të vitit 1936. Në faqen 148 të numrit të tretë kemi një shkrim me titull: Disa vërrejtje gjuhësore, nga autori I. Arbëreshi. Autori që në fillim të këtij shkrimi thotë: Ka folur mjaft Prof. A. Xhuvani ku thotë se (shih f.25): Mjerisht nuk e kemi unjisue apo unifikue ortografin e gjuhës, e duhet kohë e punë e durim për me marrinë këtij qëllimi e dëshiri të përgjithshme'. Në këtë shkrim trajtohet çështje të ndryshme gramatikore, si: 'kam qenë (f.149) për kenë, apo kenë për qenë etj. Po ashtu, autori i këtij shkrimi në vazhdim të punimit thotë: Le të mos mjerohet Selman Riza (f.29), se të gjithë një e një do të vëmë gur mbi gur sa t'a ndërtojmë shtëpinë tone. Të gjithë do të japim kontributet t'ona (Arbëreshi, 1936)'.  
Vetëdija profesionale e kombëtare të autorit, të shkrimit në fjalë është e lartë, sepse duke u bazuar në atë që ka shkruar dhe që e ka krahasuar edhe me kulturën e gjuhës greke, ai ka ofruar besueshmëri se ka kulturë akademike të ngritur, por edhe me interes për zhvillimin e shqipes.

Filip Fishta në faqen 153 të revistës 'Përpyjekja shqiptare' ka botuar shkrimin: Dy fjalë për Aleksandër Xhuvanin. Në këtë shkrim Fishta ka kritikuar për tri çështje: 1) të vrej në se krahasimet qi ban ndermjet dy libravet mbështetet mbi një gjykim të pa anësohem; 2) n'asht se trajtat qi aj i kujton 'të gabueme', kan mbështetje të forta; 3) së mbarimi le të më lejohet per ket artikull të baj oroet e para rreth gjuhës qi aj perdorë nder veprat e veta. Pikës së parë i përgjigjem me bindjen ma të fortën se shkrimit t' A. Xhuvanit i mungon pa jin a së paku një kontroll ma i fortë i pohimeve qi ban. Xhuvani shkruen tekstualisht kështu: '...një tjetër gabim gjuhe asht edhe të shkruemit e fjalëvet kuer e me muejtë me difthong, që gjinden shpeshë n' antologji të Fishtës... Në këto gabime (sic) të këtyre fjalëve antologjija e atyne tre autorëve (N. Paluca, K. Kamsi, E. Koloqi) nuk ka zanë kurrkund...(Fishta, 1936).' Studiuesit dhe dashamirët e gjuhës që kanë publikuar punimet e tyre në revistën 'Përpyjekja shqiptare' mund t'i konsiderojmë se janë kontribute themeltare për kodifikimin e gjuhës, sidomos në këto raste ku janë zhvilluar kritikata profesionale siç është rasti i Fishtës me Xhuvanin.

Në numrin e radhës e kemi një analizë nga A. Xhuvani për fjalorin e Angelo Leottit, i cili për këtë shkrim, që në fillim thotë: Fjalori i Leottit asht i katërtit Fjaluer Shqip-Italisht që kemi deri sot. I pari asht Fjalori i Junkut, i dyti i Bashkimit, i treti i Cordignano-s dhe i katërti ky i Leottit, përveç atij të vjetrit të Rossit, që asht Italiano-Epirotico dhe Epirotico-Italiano. Ky asht ma i ploti i tre të tjerëve, ka ma se 30.000 fjalë e 2500 proverba, sikurse e kallzon edhe aktori në parathënjen e tij (Xhuvani, 1937).

Xhuvani për fjalorin në fjalë thotë se është 'punë-zyre' dhe po t'i kishte respektuar disa rregulla leksikografike do të ishte edhe më i çmuar.

Në vazhdim e kemi një shkrim interesant, sepse deri me tani nuk kishim kontribute të tilla. Në rastin e gjashtëdhjetë vjetorit të Joklit, A. Xhuvani i ka kushtuar një shkrim, i cili thotë: Më 24 të muajit që shkoi Profesor Norbert Jokli mbushi 60 vjetesh. Jo vetëm ata që merren me studime të gjuhës shqipe, por gjithë intelektualët Shqiptarë e njohin mirëfillit prof. Joklin dhe punën e tij të madhe e të vlerët në lamën e vëzhgimeve të gjuhës shqipe (Xhuvani, 1937).

Referuar shkrimeve, të cilat janë prezantuar deri me tani mund të themi se revista ka dhënë një ndihmesë të çmuar për gjuhën shqipe dhe për promovimin e kontributit dhënësve.

Në numrin e shtatë të revistës e kemi një punim me titull: Përgjigje z. Filip Fishtës. Ky punim është i shkruar nga A. Xhuvani, i cili i përgjigjen Fishtës për përdorimin e shkronjës g, gj; z, x ose edhe për x-në e c-në, mirëpo i përgjigjet edhe për disa fjalë kontestuese si: prellë-a, zezelinë, sohinë (Xhuvani, 1937) etj. Shkëmbimet dhe komunikimet profesionale të këtij niveli e kanë rritur interesimin për zhvillimin dhe sistemimin e gjuhës.

Në revistë shihet se më aktiv është Xhuvani, i cili ka botuar edhe shkrime të tjera, si: Nji didaktik' e re n'italisht (Xhuvani, 1937). Në këtë shkrim përmbledh e përshkruan metodat e mësimdhënies, të cilat ishin mjaft me interes për gjuhën shqipe, sepse shoqëria ishte në hapat e parë të rrugës gjithëpërfshirëse për procesin edukativo-arsimor. Në vazhdim kemi Dhimitër Shuteriqi, i cili ka botuar një shkrim me titull: Për një Drejtim Letrar, mirëpo që në fillim ai thotë: Që ta studiojmë e ta kuptojmë mirë Litteraturën t'onë, unë jam i mendimit se, duhet të bajmë një dallim kryesor: Rilindja shqiptare dallohet nga shkrimet pre Buzukut e deri ke Kristoforidhi. Këto shkrime kanë një randësi të madhe gjuhësore, por nuk janë vepra letrare d.m.th. vepra artin (Shuteriqi, 1937).

Në revistë kemi edhe polemika të ndryshme letrare, të cilat e kanë pasuruar revistën. Në numrin e radhës kemi një shkrim me titull: Një Polimikë Letrare (Haxhiademi, 1937). Selman Riza e filloi veprimtarin e vet shkencore me studimin 'Shqiponja dhe shqipja', të cilën studim e botoi më 1936 në revistën 'Përpyekja shqiptare' (Riza, 1936), revistë kulturore, e cila është drejtuar nga Branko Merxhani. Në këtë artikull shkencor të shkruar në një toskërishte të rrjedhshme, Riza ngihet kundër dy teorive aktuale që ishin shtruar për njësimin e shqipes letrare: elbasanishtes dhe formimit të shqipes së njësuar letrare mbi bazën e përzierjes së njërive gjuhësore të të dy kryedialekteve të shqipes. Riza mori qëndrim kundër variantit letrar të elbasanishtes, sepse ky nuk kishte kurrfarë tradite shkrimi dhe në të pothuaj nuk ishin botuar asnjë vepër e letërsisë artistike shqiptare. Veç kësaj, elbasanishtja në kuptimin e ngushtë gjuhësor nuk ishte studiuar asnjëherë dhe nuk dihej cila ishte struktura e saj. Këto vërejtje të Rizës kanë mbështetje shkencore dhe dalin të qëndrueshme. Artikulli i përmendur i Selman Rizës kritikon ashpër edhe teorinë e Namik Resultit për njësimin e shqipes letrare mbi elementet e përbashkëta të të dy kryedialekteve të shqipes. Riza nuk e konsideronte këtë teori serioze... Në fund të studimit të parë të tij Riza propozonte që hëpërhë të mbështesin në funksion të dy variantet letrare të shqipes: toskërishtja dhe gegërishtja (Raka, 2004).

Riza në artikullin e tij pasues 'Dilettantismi dhe zanati' (Përpyekja shqiptare, 1938) ka thënë: 'Le t'i hedhim një vështrim sado pak kritik fjalorit të shqipes, e do të shohim se terminologjia artizanale e kemi afro qind për qind të huajtur ase nga turqishtja ase nga sllavishtja' (Riza, 1938).

Studiuesi M. Kuteli ka botuar një shkrim me interes, me titull: Poetika e Lasgush Poradecit (Kuteli, 1938), cili ka bërë një analizë të thukët për poezinë e Poradecit. Revista është pasuruar duke e publikuar edhe një shkrim me interes për gjuhën, me titull: Kritikë një kritike (Bardhi, 1938). Shkrimi i referohet Faik Konicës, i cili kishte botuar një shkrim me titull 'Ndofa? Ndoshta? Ndoshta!

Argumentimi shkencor e gjuhësor i shkrimit në fjalë e ka ngritur kujdesin profesional për përdorimin e varianteve të ndryshme dialektore, të cilat janë pasuri gjuhësore.

Në këtë periudhë, revistës i krijohen sfidat shtetërore dhe lëshohet Akti i ndalimit për katër muaj. Gjërat ndryshojnë rrënjësisht, sepse edhe situata socio-politike si ajo e brendshme, ashtu edhe jashtëmja ishte e trazuar, mirëpo revista ka vazhduar të publikojë edhe disa numra, mirëpo me një fuqi ma të dobët intelektuale.

Pas ndalesës dhe rifillimit të publikimeve, studiuesi Shpend Bardhi ka publikuar një studim me titull: Origjina e popullit shqiptar. Autori përmes këtij shkrimi ka pasqyruar kontributin e studiuesve të huaj për gjuhën dhe popullin tonë, ai ka thënë: Qëllimi praktik i këtij shkrimi asht me i banë të njohun Shqiptarit veten e vet si pjesëtar të një kombi... (Bardhi, 1938). Revista 'Përpyjekja shqiptare' mbyllet duke i publikuar edhe tri shkrime letrare: A asht poet Lasgush Poradeci (Maloki, 1938); Arti i Migjenit (Shuteriqi, 1938) dhe e fundit mbyllet edhe revista me këtë shkrim: Rreth fjalëve të Lasgushit (Bardhi, 1938).

### **Konkluzione**

Revista 'Përpyjekja shqiptare' është themeluar nga publicistët e njohur të kohës, Branko Merxhani e Petro Marko. Numri i parë doli në tetor të 1936, në faqen e dytë të kopertinës shkruante drejtor Branko Merxhani, administrator Petro Marko. Kjo revistë ishte e mirëpritur nga qytetarët, sepse ishte kulturore dhe si e tillë i mungonte shoqërisë. Ashtu si kemi prezantuar edhe në mbarështrim të punimit, u prit mirë nga rrethet intelektuale dhe ata botuan shkrimet e tyre qoftë publicitare, letrare, kritikuese e madje edhe shkencore. Studiuesit që mund t'i veçojmë janë: Xhuvani, Riza, Çabej, Bardhi, Kuteli, Shuteriqi, Poradeci, Migjeni etj. Kryeredaktori dhe revista janë goditur nga censura socio-politike e kohës. Branko Merxhani më së miri e ka shprehur ideologjinë e tij në shkrimin 'Pse nuk jam marksist', e si pasojë shkaktoi ikjen e Petro Markos në numrin e tretë të revistës. Revista është botuar në gjuhën shqipe, mirëpo dominojnë shkrimet referuar dialektit toskë, por nuk kanë munguar edhe shkrimet e dialektit gegë, apo variantet e nëndialekteve. Disa shkrime janë botuar edhe në gjuhën frënge.

Në këtë studim janë trajtuar mbi njëzet punime, të cilat të gjitha janë dedikime për gjuhën. Autorët që kanë kontribuar me idetë e tyre, i konsideroj se janë pishtarët themelvënës të shqipes standarde. Për të përfunduar këtë punim, e rikujtoj edhe një punë timin serioz që e kam bërë për revistën 'Përpyjekja shqiptare', pra i kam studiuar mbi një mijë kompozita, kurse bashkë me redaktorin shkencor prof.dr. Ruzhdi Ushakun jemi pajtuar që të themi se janë mbi treqind kompozita<sup>228</sup> të cilat janë evidencuar në korpusin e revistës, por tani janë edhe në monografinë time.

### **Referenca**

- Arbëreshi, I. (1936). Disa vërretje gjuhësore. *Përpyjekja shqiptare*, 3, 148.  
Bardhi, Sh. (1938). Kritikë një kritike. *Përpyjekja shqiptare*, 17, 271.  
Bardhi, Sh. (1938). Origjina e popullit shqiptar. *Përpyjekja shqiptare*, 18–24, 332.  
Bardhi, Sh. (1938). Rreth fjalëve të Lasgushit. *Përpyjekja shqiptare*, 18–24, 405.  
Çabej, E. (1936). Një libër mbi literaturën shqipe. *Përpyjekja shqiptare*, 2, 124.  
Fishat, F. (1936). Dy fjalë me Aleksandër Xhuvanin. *Përpyjekja shqiptare*, 3, 153.  
Haxhiademi, E. (1937). Një polimikë letrare. *Përpyjekja shqiptare*, 8, 124.

<sup>228</sup> Shkelqim Millaku, Kërkime gjuhësore 1, Prishtinë, 2011.

[https://www.academia.edu/6051262/Studime\\_gjuh%C3%ABsore\\_I\\_Kompozitat](https://www.academia.edu/6051262/Studime_gjuh%C3%ABsore_I_Kompozitat)

- Kuteli, M. (1938). Poetika e Lasgush Poradecit. *Përpyjekja shqiptare*, 17, 243.
- Leka, P. (n.d.). Branko Merxhani, korife i publicistikës shqiptare. *Ars Albanica – Portal kulturor*.  
<https://www.arsalbanica.mk/branko-merxhani-korife-i-publicistikës-shqiptare/>
- Maloki, K. (1938). A asht poet Lasgush Poradeci? *Përpyjekja shqiptare*, 18–24, 333.
- Millaku, Sh. (2011). *Kërkime gjuhësore 1*. Prishtinë.
- Millaku, Sh. (2017, October 21). Kontributi i revistës "Përpyjekja shqiptare" për gjuhën, kulturën dhe identitetin kombëtar shqiptar. *SSRN*. <https://ssrn.com/abstract=3056710> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3056710>
- Raka, F. (1994). Rreth veprimtarisë së prof. Selam Rizës në fushë të shqipes letrare. *Gjurmime Albanologjike: Seria e shkencave filologjike*, 23, 45–46.
- Redaksia e revistës "Përpyjekja shqiptare". (1936–1938). *Përpyjekja shqiptare*, nr. 1–24. Tiranë.
- Riza, S. (1936). Shqiponja dhe shqipja. *Përpyjekja shqiptare*, 1, 28–31.
- Riza, S. (1938). Dilettantismi dhe zanati. *Përpyjekja shqiptare*, 14–15, 82–83.
- Shuteriqi, Dh. (1937). Për një drejtim letrar. *Përpyjekja shqiptare*, 8, 101.
- Shuteriqi, Dh. (1938). Arti i Migjenit. *Përpyjekja shqiptare*, 18–24, 399.
- Xhuvani, A. (1936). Dy antologjijat shqipe. *Përpyjekja shqiptare*, 1, 22.
- Xhuvani, A. (1936). Kritika, e kritikës mbi kritikën. *Përpyjekja shqiptare*, 1, 90.
- Xhuvani, A. (1937). Fjalori i Angelo Leottit. *Përpyjekja shqiptare*, 4–6, 209.
- Xhuvani, A. (1937). Gjashtëdhjetëvjetori i Prof. Joklit. *Përpyjekja shqiptare*, 4–6, 209.
- Xhuvani, A. (1937). Nji didaktik' e re n'italisht. *Përpyjekja shqiptare*, 8, 81. (Libri: G. Lombardo-Radice, *Lezioni di Didattica*, Palermo, 1936).
- Xhuvani, A. (1937). Përgjigje z. Filip Fishtës. *Përpyjekja shqiptare*, 7, 31.